

STATUT

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "ADV Tourism and Hospitality" Shpk

Në këtë statut

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë;
- "Shoqëri" është Shoqëria "ADV Tourism and Hospitality" SHPK

Kreu I - Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1: Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më datë 01.08.2018 themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin "ADV Tourism and Hospitality" SH.P.K. nga ortaket si më poshtë:

- 1- Vojsava Meneri, e bija e Xhemal, e datëlindjes 28.08.1951.
- 2- Admira Meneri, e bija e Agimit dhe e Vojsavës, e datëlindjes 22/04/1982.
- 3- Dorina Meneri, e bija e Agimit dhe e Vojsavës, e datëlindjes 17/09/1984.

Neni 2: Objekti

2.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

-Aktivitete në fushën e hoteleri-turizmit dhe kateringut. Në veçanti, dhënie me qira afatshkurtër të ambienteve të mobiluara për turistët nëpërmjet platformave në internet. Ofrimin për turistët të akomodimit dhe ushqimit në të gjitha vaktet. Ofrimi i shërbimeve të guidës turistike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

-Shfrytëzimi për aktivitete hotelerie të pasurisë së regjistruar pranë ZVRPP Tiranë, identifikuar me Certifikatën e Pronësisë nr. 1500066, zona kadastrale 8350, numër pasurie 3/283, volumi 40, faqe 148 e përbërë nga Truall me sipërfaqe 121 m2 dhe ndërtesë me sipërfaqe 45.30 m2, pasuri e cila kalohet në pronësi të shoqërisë nga ortaket nëpërmjet kontributit në natyrë.

-Ushtrimi i aktivitetit të dhënies së makinave me qira.

-Shoqëria mund të zhvillojë çdo aktivitet tjetër të lejuar në ligj.

2.2 Objekti mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Neni 3: Kohëzgjatja

Shoqëria krijohet për një afat të pacaktuar.

Neni 4: Selia - Stema

4.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga e Durrësit, nr. 156/2, Mbrapa Shpresa-Al, banesa njëkatëshe, Zona kadastrale 8350, pasuria nr. 3/282, volumi 40, faqja 147, Tiranë.

4.2 Selia mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

4.3 Shoqëria ka stemën dhe vulën e saj e cila përbëhet nga të dhënat e saj (sipas rastit adresa e selisë, NUIS-i apo informacione të tjera) dhe emrin i saj i shkruaj me germa dhe shkronja në madhësi të ndryshme (ADV Tourism and Hospitality) dhe ngjyra të ndryshme. Stema përfundimtare e shoqërisë do të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve pas regjistrimit të shoqërisë.

Kreu II - KAPITALI

Neni 5: Kapitali themeltar

5.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 5.000.000 (pesë milionë) lekë.

5.2 Në përputhje me nenin 68, paragrafi 5, të ligjit nr. 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" kapitali themeltar shlyhet nga ortakët nëpërmjet kontributit në natyrë duke i kaluar në pronësi shoqërisë pasurinë e regjistruar pranë ZVRPP Tiranë, identifikuar me Certifikatën e Pronësisë nr. 1500066, zona kadastrale 8350, numër pasurie 3/283, volumi 40, faqe 148 e përbërë nga Truall me sipërfaqe 121 m2 dhe ndërtesë me sipërfaqe 45.30 m2 që ndodhet në bashkëpronësi të pandarë të ortakëve.

5.3 Në përputhje me nenin 68, paragrafi 6, të ligjit nr. 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" ortakët dakordësohen që vlera e pasurisë me nr. 3/283, të sipërpërmendur, që i transferohet shoqërisë si kontributit në natyrë është 5.000.000 (pesë milionë) lekë. Kjo vlerë shlyhet plotësisht në natyrë nëpërmjet kalimit në pronësi të shoqërisë të pasurisë së regjistruar pranë ZVRPP Tiranë, identifikuar me Certifikatën e Pronësisë nr. 1500066, zona kadastrale 8350, numër pasurie 3/283, volumi 40, faqe 148 e përbërë nga Truall me sipërfaqe 121 m2 dhe ndërtesë me sipërfaqe 45.30 m2 që ndodhet në bashkëpronësi të pandarë të ortakëve.

5.4 Kapitali themeltar ndahet në 3 kuota të cilat zotërohen si vijon:

- Ortakja themeluese **Vojsava Meneri** është zotëruese e një kuote të barabartë me 1.700.000 (një milion e shtatëqind mijë lekë) që përfaqëson 34 % (tridhjetë e katër përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

- Ortakja themeluese **Admira Meneri** është zotëruese e një kuote të barabartë me 1.650.000 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë lekë) që përfaqëson 33 % (tridhjetë e tre përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

- Ortakja themeluese **Dorina Meneri** është zotëruese e një kuote të barabartë me 1.650.000 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë lekë) që përfaqëson 33 % (tridhjetë e tre përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6: Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, kapitali i shoqërisë mund të zvogëlohet ose të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë.

Neni 7: Transferimi i kuotave të kapitalit

7.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) shitblerjes;
- b) trashëgimisë;
- c) dhurimit;
- ç) Dhënies si kontribut në kapitalin e një shoqërie tjetër;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

7.2 Ortakët mund të shesin lirisht kuotën e tyre personave të tretë.

KREU III - ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8: Organet Vendimmarrëse

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- 1- Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.
- 2- Administratori.

Neni 9: Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve



Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme vendos për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorit;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) ndryshimin e selisë së shoqërisë;
- j) marrjen e një huaje në çfarëdo vlere nga ortakët;
- k) marrjen e një kredie apo huaje nga një institucion financiar;
- l) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 10: Administrimi

10.1 Administrator i parë i shoqërisë është ortakë Znj. Vojsava Meneri.

10.2 Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

10.3 Administratori shkarkohet dhe/ose emërohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve me një shumicë prej 51% të votave.


10.4 Administratori nuk lejohet të tjetërsojë pasuri të shoqërisë apo të kryejë veprime juridike që kanë një vlerë mbi 1.000.000 lekë (në vit) pa miratimin paraprak të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 11: Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare në raport me të tretët dhe pranë organeve shtetërore;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara ortakut në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Neni 12: Përgjegjësitë e Administratorit



Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Kreu IV - Viti financiar - ekspertët

Neni 13: Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 13: Ekspertët

13.1 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tilla të ngarkuar nga ana e ortakëve.

13.2 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar.

Kreu V - Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 14: Prishja dhe likuidimi

14.1 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
- b) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

14.2 Në këtë rast Ortaku merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese "Shoqëri në likuidim e sipër".

14.3 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pague, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

14.4 Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku.

14.5 Në rast se në përfundim të procesit të likuidimit mbetet pasuri nga shoqëria atëherë ajo kalon në emër të ortakëve në raport me kuotat që zotërojnë në kapitalin themeltar të shoqërisë.


Neni 15: Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 16: Baza Ligjore

16.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

16.2 Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.




Neni 17: Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

ORTAKËT E SHOQËRISË "ADV Tourism and Hospitality" SHPK

VOJSAVA MENERI


VOJSAVA MENERI

_____ 

ADMIRA MENERI

(perfaqësuar nga e ëma, Vojsava Meneri, në bazë të prokurës noteriale datë 17/07/2018 përpara Robert Wood, Noter Publik në Angli dhe Uells)

VOJSAVA MENERI

_____ 

DORINA MENERI

(perfaqësuar nga e ëma, Vojsava Meneri, në bazë të prokurës noteriale datë 17/07/2018 përpara Robert Wood, Noter Publik në Angli dhe Uells)

VOJSAVA MENERI

_____ 